

Kërkim? Mendo Patentat



Çmimi i Shpikësit European – Festimi i shpirtit shpikës

Fotot e kësaj broshure tregojnë disa shembuj të finalistëve të kohëve të fundit dhe fituesit në kategorinë e Kërkimit në eventin e cmimit të shpikësit në EPO. Më shumë informacion - duke përfshirë detajet e hyrjes – në website EPO:

www.epo.org/learning-events/european-inventor/about.html

Përmbajtja

- 4** Vendorsja e rezultateve të kërkimit në përdorim të shoqërisë
- 6** Patentimi i kërkuesve njihet gjithmonë e më shumë si matës performacë
- 11** Trendet në patentimin e kërkimeve
- 16** Mendo patentat–nga fillimi
- 22** Vlera tregëtare e patentave
- 24** Kërko milionerë?

Vendosja e rezultateve të kërkimit në përdorim të shoqërisë

Deri në ditët e sotme, kërkuesit në universitete dhe organizatat kërkimore publike (OKP), kanë patur shpesh përfshirje të limituar me patentat. Kjo panoramë po ndryshon. Kjo broshurë paraqet një pamje se si tani kërkuesit po përdorin gjithmonë dhe më shumë patentat si burim informacioni, si matëse të suksesit të tyre dhe si një mjet i fuqishëm në kontributin e rritjes ekonomike – për shoqërinë si një e tërë dhe, në disa raste, për veten e tyre, kolegët dhe familjet.

Në kohën kur Zyra e Patentave Europiane u themelua në vitin 1977, kërkuesit në Europë nuk e përdornin sistemin e patentave krahasuar me homologët e tyre në SHBA.

Atëherë, ka patur shumë pak patentime nga Kina dhe Korea – ekonomi që në ditët e sotme janë në majat e tabelave ndërkombëtare për numrin e aplikimeve të patentave.

Sot, universitetet Europiane lider në kërkime inkurajohen të transferojnë njohuri dhe teknologji në mënyrë që ekonomia dhe shoqëria të përfitojë në mënyrë direkte dhe të matshme.

Aplikimet e Patentave – së bashku me rritjen e numrit të publikimeve të dokumenteve kërkimore – tashmë konsiderohen si matës të performancës institucionale ose individuale.

Në Maj të vitit 2013, EPO organizoi një konferencë me titull “Krijimi i tregjeve nga rezultatet e kërkimit”. Në këtë eveniment morrën pjesë më shumë se 300 delegatë nga 40 shtete të cilët diskutuan mënyra të marrjes së ideve duke u fokusuar në fazën fillestare të hyrjes deri në pikën e pranimet të tyre në treg. Të drejtat e Pronësisë Intelktuale – dhe patentat në veçanti – u vunë re më shumë.

Kjo broshurë tregon se si kultura e PI po ndryshon në Europë dhe në rang ndërkombëtar, dhe drejton kërkuesit drejt burimeve të informacionit të detajuar. Eshtë pjesë e aktiviteteve të Akademisë Europiane të Patentave për të ndihmuar kërkuesit e universiteteve dhe OKVve të marrin përfitimet maksimale ekonomike dhe sociale nga kontributi i tyre në përmirësimet shkencore dhe teknologjike.

Patentimi i kërkuesve njihet gjithmonë e më shumë si matës performace

Output-i i universiteteve dhe OPK, sot gjykohet si nga efekti që ka në shoqëri po ashtu dhe nga publikimet e dokumenteve kërkimore. Patentat konsiderohen sot si matëse të rëndësishme të performancës, si për institucionin dhe për kërkimet individuale.

Deri disa vite më parë, shumë kërkues kishin mendimin se patentat mund të limitonin transferimin e dijes dhe njohurive. Universitetet Europiane dhe OPK inkurajonin kërkuesit të fokusoheshin më shumë në publikimin e dokumentave shkencorë dhe jo në sigurimin e patentave të punëve të tyre. Kjo po ndryshon, sepse politikat e qeverive tashmë promovojnë pronësinë e të drejtave të patentës si një nevojë e rëndësishme e transferimit të dijes.

Shqetësimi në rritje i qeverive për kthimin e investimit në financimin e kërkimeve ka sjellë një fokus më të mprehtë në matësit. Patentat janë të paktën po aq të rëndësishme sa dokumentet shkencore, veçanërisht kur vlerësohen impaktet sociale dhe ekonomike të kërkimit.

“... shoqëria i shpërblen kërkuesit në universitete për publikimet e tyre në gazeta shkencore, konferenca dhe vende të tjera.. Duke bërë këtë shkenca avancon – po ashtu edhe karriera e tyre, sepse arkiva e publikimeve është një kriter standard i suksesit akademik [...] shoqëria gjithmonë e më shumë pret nga ata dhe institucionet e tyre të krijojnë të ardhura nga zbulimet, duke i patentuar. Duke bërë këtë ekonomia përparon duke u lejuar të tjerëve të investojnë pa frikën e vjedhjes intelektuale.”

Imperial Innovations, London, June 2014:

“A survey of European technology transfer offices on patent practice and perceptions”

Publikim apo patent?

Pjesa më e madhe e kërkuesve e dinë që një patentë do të jepet vetëm për një shpikje, detajet e së cilës nuk janë publikuar asnjëherë më parë. Publikimi është parë si më i rëndësishëm dhe urgjent duke e krahasuar me marrjen e një patente, për arsye se performanca individuale dhe institucionale shumë shpesh gjykohej nga publikimi i dokumenteve shkencorë.

Kërkuesit të cilët e dinë se si funksionon procesi i patentës po kuptojnë se është plotësisht e mundshme që fillimisht të aplikohet për një patentë dhe menjëherë pas aplikimit të publikohet një dokument shkencor. Pasi të ketë përfunduar aplikimi për patentë, kërkuesit mund të publikojnë shpikjen pa çenuar mbrojtjen e saj.

Kjo është pranuar në kërkimin e bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tregut të Brendshëm dhe Kërkimit të Komisionit Europian, i cili tregon se në rastet më të shumta nuk ka vonesa në publikime të cilat lidhen me aplikimet e patentave.

“Praktika e kombinimit të patentimit dhe publikimit po përdoret gjithmonë dhe me shumë për arsye se i lejon kërkuesit të përfitojnë nga të dyja aktivitetet. Në fakt, ata fitojnë avantazh nga fitimet e patentave dhe njihen në nivel akademik për cilësinë e dokumentave të tyre.”

European Commission FactSheet
“Patenting vs publishing”

A do të mundte Thomas Edison të merrte mandatin?

Universitetet e SHBA aplikojnë pesë herë më shumë se homologët europianë dhe po ashtu akademikët amerikanë janë më të hapur të pranojnë përfshirjen e patentave si matës performance.


Një studim i vitit 2013 nga Goldstein dhe Rehbogen me anëtarë nga 71 institucione konfirmoi që: 80 % e të anketuarve ranë dakord me shpërblimin e fakultetit për shpikjet e patentueshme në vendimet e zotërimit.



Mechanism 9

Biokimisti **Thomas Tuschl's** metoda tabu-thyerëse e "fikjes" të geneve njerëzore është bërë një mjet jetësor në zhvillimin e mënyrave të reja në diagnostikimin dhe kushteve të kurimit nga hemofilia në kolesterolin e lartë. Tuschl pati sukses në përshtatjen e një teknike të "qetësimit të gjenit" e cila përdoret në gjenet njerëzore, e njohur si interference RNA (RNAi). Kompania amerikane "Alnylam", të cilën Tuschl e bashkëthemeloi në 2002, ka licensuar ekskluzivisht të drejtat e metodës së tij. Ai vazhdon akoma të mbajë pozicionin e këshilltarit shkencor në këtë kompani. Startup-et e bioteknologjisë RNAi kanë sjellë investime me biliona dollarë nga burime të ndryshme duke përfshirë kompani të mëdha farmaceutike. Gjiganti farmaceutik Roche bleu një licensë jo ekskluzive të teknologjisë së Alnylam në 2007 me një vlerë prej 300 milion dollarë amerikan.

siRNAs
(2)



Ky studim u diskutua në Konferencën Vjetore të Akademisë Kombëtare të Shpikësve në vitin 2013, me temë kryesore “ Ndryshimi i kulturës akademike: vlerësimi i patentave dhe tregëtimi drejt mbajtjes dhe rritjes në karrierë”.

Në të njëjtën konferencë, Morteza Gharib, zëvendës kancelare e Caltech, ishte pjesë e diskutimit në panel mbi pyetjen se si shpikësi i njohur botëror Thomas Edison (1847 – 1931) do të sillej përpara një komisioni universitar:

“Edisoni përbën një rast testimi interesant. Me më shumë se 1000 patenta, Edison ishte një shpikës shumë prodhues. Megjithatë, ai asnjëherë nuk publikoi dokumenta në gazeta shkencore. Në rast se ne do duam më shumë shkencëtarë, dhe duke konsideruar sfidat teknologjike të shekullit të 21 mund të themi pa frikë që po, si do te vlerësohet dhe shpërblehet puna kërkimore e tyre?”

Morteza Gharib

Zevendes Kancelare e Caltech

Trendi në patentimin e kërkimeve

Aplikimet e patentave nga universitetet dhe OPK po rriten globalisht, por Europa akoma mbetet pas SHBA dhe numri aplikimeve Aziatike po rritet. Në mënyrë që të rritet konkurrenca, BE ka vendosur një target të ri dhe ambicoz për vendet anëtare për të investuar 3% të të ardhurave kombëtare në punë kërkimore. Në të njëjtën kohë, një sistem i ri i patentave unitare do të ndihmojë kërkuesit të sigurojnë të drejtat e PI në të gjithë Europën, më lehtë dhe me kosto më të ulët.

Institucionet më të rëndësishme Europiane e kanë parë shumë herët vlerën e patentës si një mjet i vlefshëm për zhvillimin tregëtar. Zyra e transferimit të teknologjisë (TTO-ss) në universitete të vlerësuara insiston në të drejta të forta të PI, zakonisht në formën e patentave. Drejtorët e TTO-ss së universiteteve dinë që në mungesë të mbrojtjes së plotë të PI, tërheqja e investimeve ose gjenerimi i bizneseve kooperative është i vështirë.


Në vitet e fundit, universitetet dhe OPK e kanë rritur numrin e aplikimeve të tyre për patentë, si në numër të aplikimeve po ashtu dhe në pjesën e tyre të totalit::

“Universitetet dhe OPK kanë aplikuar gjithmonë e më shumë patenta gjatë viteve, të cilat përbejnë afërsisht 7.5 % të të gjitha aplikimeve të publikuara në 2013. Ato nga Europa dhe nga SHBA tradicionalisht përbëjnë grupin e madh të aplikimeve por ato Aziatike po i afrohen këtij grupi me shpejtësi. Universitetet dhe OPK nga vende me të ardhura të mesme, gjatë viteve të fundit e kanë rritur ndjeshëm përdorimin e sistemit të patentave.”

WIPO

Patent Cooperation Treaty Yearly Review 2014

Trendi I aplikimeve të universiteteve dhe OPK



Shënim: të dhënat e PCT bazohen në datat e publikimeve dhe emrat e aplikantëve. Sektori universitar përfshin të gjitha llojet e institucioneve edukative. OPK përfshin organizatat private jo-fitim prurëse dhe spitalet.

Burimi: Të dhëna statistikore WIPO, Mars 2014

Më shume theks mbi patentat në politikën Europiane

Aktivitetet kërkimore të universiteteve dhe OPK Europiane kanë avantazh konkurrues kudo në botë, edhe pse në të kaluarën ato e kanë përdorur më pak sistemin e patentave, krahasuar me SHBA-të dhe Japoninë. Sipas statistikave më të fundit, shtetet Aziatike, veçanërisht Koreja e Jugut dhe Kina, kanë rritje të dukshme.

BE ka për qëllim të shtojë 800 bn euro investimit të vet vjetor deri në 2025, pjesë kjo e strategjisë globale të konkurrencës. Me programin kërkimor ekzistues prej €80 bn, Horizon 2020, është vendosur një target investimi në kërkim dhe zhvillim i cili përbën 3 % të GDP-së së BE. Patentat janë një nga matjet kryesore në të cilat BE do të vlerësojë progresin.

Sistemi i ri i patentimit në Europe

Një sistem i ri patentash të përbashkëta europiane pritet të aprovohet në vitin 2016. Sipas këtij sistemi të ri, në momentin e grantit aplikantëve do t'u ofrohet opsioni i ri i “vlefshmërisë të patentave me efekt unitar”. Sistemi i ri është krijuar për t'u ardhur në ndihmë veçanërisht institucioneve akademike kërkimore dhe SME-ve, duke:

- Ulur kostot
- Vendosur kritere kërkimi më të thjeshta

“Firmosja e një marrëveshjeje të shumëpritur për patentë unitare më 19 Shkurt 2013, mund të kontribuojë në rritjen e pranimin të patentave duke fituar pikë gjatë vlerësimit të karrierës akademike apo vlerësimit të dhënies së patentës.”

EuroScientist
Mars 2013





Philippe Cinquin, Serge Cosnier dhe skuadra e tyre në Universitetin Joseph Fourier në France, shpikën atë që efektivisht është : “bateria e gjallë” – një qelizë energjie dhe kabuj përçues të cilët kombinohen me enzima reaktive të cilat kanë fuqinë që nga sasia e pafund e glukozës në trupin e njeriut, të krijohet elektricitet. Kërkimet e shpikësve ofrojnë të ardhme tërheqëse në shumë fusha, veçanërisht në industrinë mjeksore. Në 2010, tregu global për implantet mjeksore mikro elektrike, akesorët dhe furnizimet, vlerësohej me një vlerë prej 11.1 bn US \$, shifër kjo e cila pritet të rritet në \$17.9 bn në 2016.

Mendo patentat – nga fillimi

Që nga fillimi i një projekti të ri kërkimor, duhet të konsiderohet se informacioni për patentat mund të ndihmojë dhe nëse mund të ketë perfitime në depozitim të një aplikimi për patentë. Vendimet për patentimin të cilat merren në një fazë të hershme mund të ndikojë mënyrën se si skuadra e kërkimit i afrohet një projekti të ri dhe cila është vlera afatgjatë e projektit.

Patentat si një burim informacioni

Një kërkim sistematik i të dhënave të patentave mund të jetë i vlefshëm sepse:

- Patentat përmbajnë informacion të pasur teknik i cili shpesh është i rrallë. Kërkimi në fazën fillestare redukton rrezikun e harxhimit të kohës dhe shpenzimeve duke përsëritur kërkime të mëparshme.
- Një kërkim për patentë të tregon nëse një shpikje përbën inovacion dhe nëse mund të patentohet.
- Të tregon nëse ka liri veprimi apo ekziston rreziku i çenimit të të drejtave të një patente ekzistuese.
- Tregon se mbi çfarë partnerët ose konkurrentët potencialë janë duke punuar. Duke analizuar aktivitetin e patentave në organizatat e tjera është e mundshme të vihen re ndryshimet në drejtimit e kërkimeve të tyre.

www.epo.org/searching/free/espacenet.html

Rëndësia e konfidencialitetit

Patentat jepen vetëm për të mbrojtur shpikjet të cilat sjellin risi. Një shpikje sjell risi vetëm nëse nuk është publikuar apo hapur për publikun përpara datës së depozitimit të aplikimit për shpikjen e kërkuar. Kjo aplikohet në artikuj dhe gazeta, prezantime në konferenca dhe çfarëdo zbulim tjetër të një natyre jo – konfidenciale. Kërkuesit të cilët duan të diskutojnë kërkimin e tyre – veçanërisht me këdo tjetër që nuk i përket grupit të tyre të kërkimit – duhet të sigurohen që fillimisht të finalizohet një marrëveshje konfidencialiteti.

Kur duhet publikuar

Në pjesën më të madhe të sistemeve të patentimit, dokumenti i parë i patentës publikohet brenda 18 muajve nga data kur aplikimi është depozituar. Dokumenti i dytë i patentës publikohet nëse patenta jepet apo grantohet. Në momentin kur një aplikim për patentë depozitohet, aplikuesi mund ta publikojë shpikjen e kërkuar, pa rrezikuar mbrojtjen e patentës për atë shpikje.

Mbajtja e shënimeve të mira laboratorike

Pjesa më e madhe e laboratorëve të kërkimit insistojnë që shënimet laboratorike të detajuara, duhet të mbahen dhe kujdesen për të gjitha ato kërkime nga të cilat mund të ketë rezultate të frytshme.

Rëndësia e Marrëveshjeve të projekteve

Gjatë një projekti kërkimor tipik mund të gjenerohen ide nga shumë burime. Natyra bashkëpunuese e kërkimit gjithnjë e në rritje, nënkupton që patentat dhe të drejta të tjera të lidhura me PI mund të kenë më shumë se një pronar. Duke përcaktuar të drejtat e çdo pale që në fillim me një marrëveshje të shkruar bënë të mundur mënjanimin e konflikteve të mëvonshme. Kjo është shumë e rëndësishme veçanërisht kur përfshihen të ardhurat tregtare.

Kush zotëron nje patentë?

Kërkuesit mund të jenë të pasigurt për llojin e pronësisë që ata mund të kenë në patenta dhe objekte të tjera të PI. Ligjet të cilat përcaktojnë përgjigjet ndryshojnë nga njëri shtet europian në shtetin tjetër. Prandaj kërkuesit duhet të kontrollojnë kontratat e tyre të punës përsa i përket të drejtave të PI që punonjësit e tyre duhet të kenë për shpikjet e lidhura me punën.

Këshilla profesionale, burime të dobishme dhe materialet e trainimit

Pjesa më e madhe e universiteteve dhe shumë OPK do të kenë një TTO dhe link për avokatët e kualifikuar të patentave. Këto duhet të jenë dera e parë pritëse në lidhje me kërkimet apo pyetjet lidhur me PI.

Kërkuesit të cilët duhet të kenë kontakt direkt me këshilluesit e kualifikuar dhe profesionalë apo përfaqësuesit e autorizuar, mund ti gjejnë në faqen zyrtare të EPO:

www.epo.org/applying/online-services/representatives.html

Instituti i Përfaqësuesve të Autorizuar përpara EPO (epi) ka gjithashtu një listë të shoqatave kombëtare të përfaqësuesve të autorizuar në website-in e tyre zyrtar:

www.patentepi.com/en/epi-links/national-associations-of-patent-attorneys

Zyra Europiane e Patentave

Një game e gjerë e materialeve trajnuese, trajnimeve online, transmetimeve dhe leksionet mbi patentat dhe sistemin European të patentimit gjenden në :

www.epo.org/learning-events/e-learning.html

Baza e të dhënave e patentave, e cili përbën një pasuri të informacionit teknik dhe shkencor, është e disponueshme pa pagesë dhe e publikuar vetëm në:

www.epo.org/searching.html

Espacenet ofron hyrje falas në më shumë se 90 milion dokumente ndërkombëtare për patenta , dokumente këto të cilat përmbajnë informacion për shpikjet dhe zhvillimet teknike që nga viti 1836 deri në ditët e sotme. Mund të kërkohet në shumë gjuhë Europiane dhe Ndërkombëtare duke përfshirë Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, gjuhën Kineze, Japoneze dhe Koreane.

www.epo.org/searching/free/espacenet.html

Komisioni Europian

Publikimi i Komisionit Europian me titull: “Rekomandim mbi menaxhimin e IP në aktivitetet e transferimit të njohurive dhe kodit të praktikave për universitetet dhe organizata të tjera kërkimore publike është i disponueshëm si PDF apo në kopje fizike nga libraria e KE.

www.bookshop.europa.eu

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

“Patentimi Akademik: Si universitetet dhe organizata kërkimore publike po përdorin pronësinë e tyre intelektuale për të lulëzuar kërkimin dhe mbështesin nisjet e reja”

www.wipo.int/sme/en/documents/academic_patenting.html

“Lehtësimi i prodhimit të drogës gjenerike: përjashtimet “Bolar” në rang ndërkombëtar”

www.wipo.int/wipo_magazine/en/2014/03/article_0004.html





Puna e Znj. **Christine Van Broeckhoven's** fokusohet në sëmundjet e trurit neurodegenerative. Duke u bazuar në punën kërkimore të Van Broekhoven, po bëhen testime njerëzore të cilat premtojnë ilaçe për trajtimin e sëmundjes Alzajmer. Ajo punon në një laborator në Institutin e Bioteknologjisë në Belgjikë, ku më shumë se 1200 shkencëtarë nga 60 shtete performojnë duke u bazuar në molekulat e jetës. Në 2010, kostot sociale të sëmundjes Alzajmer dhe forma të tjera “çmëndurie” arritën shumën prej afërsisht 453 bilion euro ose afërsisht 1 % të GDP – kosto të cilat mund të ulen në mënyrë drastike nëse koha e nevojshme do të jetë edhe një vit më shumë.

Vlera tregëtare e patentave

Mënyra se si universitetet dhe OPK operojnë me bizneset për të transferuar shkencën nga laboratorit në treg po evolon.

Universitetet dhe OPK në Europë po patentojnë gjithmonë e më shumë punimet e tyre dhe po e kthejnë PI e tyre në sipërmarrje të suksesshme tregtare.

Shumë nga Universitetet më të rëndësishëm europian kanë TTO të cilat lehtësojnë bizneset që lindin prej tyre duke u bazuar në teknologjinë e zhvilluar të universitetit. Një numër i madh gjenerojnë të ardhura nga programet kërkimore të kompanive private të cilat shpesh marrin pronësinë e patentave dhe të drejta të tjera të PI. Një raport i OECD, “Komericializimi i Kërkimit Publik: Trende dhe Strategji të reja”, shikon te ky imazh në zhvillim dhe sjell një rishikim të politikave të qeverisë në rang institucional. Gjithashtu, krahason performancën në shtetet e OECD, universitete dhe institucione publike të kërkimit.

“Krijimi i një kompanie të lindur nga universiteti i jep kërkuesit shkencor një kuptim të një bote tjetër me mundësi të cilat është e vështirë ti arrish në një mjedis akademik të zakonshëm[...] Këshilla më e mirë që mund t’i jepet një shkencëtari i cili dëshiron të fillojë një kompani “bijë” do të ishte që të kërkonte ndihmën e ekspertave që në fillim [...] Kur bëhet një zbulim me potencial tregtar, mund të bëhet e vështirë të zotërosh instiktin akademik për ta bërë pjesë të një abstrakti apo ta bësh pjesë të dispozitivëve në prezantimin e ardhshëm. Por, duhet ta vendosësh poshtë kapeles dhe mendosh për ta mbrojtur fillimisht, sepse nëse i tregon të dhënat në një forum publik mund të ndikojë pronësinë intelektuale të cilën kërkon të depozitosh.”

Profesor Stefan Neubauer, Kardiolog dhe Drejtor i Qendrës për Resonancën Klinike Magnetike në Oxford

Artikulli i Këshillit Kërkimor Medicinal, Britani e Madhe, 24 Mars 2015

Një konferencë në një temë të ngjashme, “Krijimi i Tregjeve nga rezultatet e kërkimit”, u organizua nga Zyra Europiane e Patentave, Organizata për Bashkpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik dhe Universiteti Teknik i Mynihut në Maj të 2013. Në seancat pleanre të saj, specialist dhe zyrtarë me ekperience nga EPO, OECD, dhe Federata Gjermane dhe TUM diskutuan procesin me anë të së cilit universitetet mund të luajnë një rol edhe më dinamik në sistemin inovativ të një shteti.

Ata rekomanduan që universitetet duhet të kenë si qëllim:

- Menaxhojnë më mire PI të tyre
- Eksplorojnë kanale të reja në tregje nëpërmjet shkencës së hapur dhe sipërmarrjes
- Krijojnë modele të hapura për bashkëpunim
- Konsiderojnë ndryshimet në mënyrën se si organizojnë vetveten.

“Një impakt i menjëhershëm po bëhet me anë të transferimit të njohurisë nga sipërmarrja: si brenda dhe jashtë universiteteve. Shumë kërkues kanë krijuar kompani të tyre por këto shpesh herë mbeten të vogla në përmasa. Kompanitë që kanë rritje të shpejtë të cilat krijojnë mijra vende pune, vecanërisht duke u bazuar në eksperiencën e SHBA, përgjithësisht janë themeluar nga studentë të cilët i vetëthemelojnë kur largohen ose braktisin universitetin.”

***Raport mbi Konferencën “Krijimi i Tregjeve nga rezultatet e Kërkimit”
Maj 2013***

Kërko për Milionerë?

Kërkuesit sipërmarrës në Europë janë gjithmonë e më shumë të përfshirë në biznese “spin out”¹ të cilat po marrin sukses tregëtar. Universitetet, industria dhe fondet kaptale private i njohin patentat si asete me vlerë të cilat krijojnë të ardhura ose fitim kapital.

Sipas një tabele nga revista Spear dhe WealthInsight, diplomat inxhinierike prodhojnë pjesën më të madhe të milionerëve. Për përgatitjen e listës, WealthInsight konsideroi një bazë të dhënash prej milionerësh me 70 000 dollarë në më shumë se 200 shtete. Shtetet Europiane me universitetet në “500 më të mirët” përfshinin Francën, Gjermaninë, Italinë, Suedinë, dhe Britaninë e Madhe.

Vlerësimi i progresit teknologjik dhe impakti i tij në shoqëri

Suksesi tregëtar është një prodhim i matshëm nga suksesi i kërkimit. Por nuk është faktori i vetëm i cili njihet nga çmimi i shpikësit European të EPO. I krijuar në 2006, ky çmim nderon kreativitetin e shpikësve të cilët përdorin aftësitë e tyre teknike, shkencore dhe intelektuale për të dhënë një kontribut në progresin teknologjik dhe rritjen ekonomike dhe të përmirësojnë jetën e përditshme të njerëzve.

1. spin out: tipi i kompanive që lindin si pasojë e shkëputjes prej kompanisë mëmë dhe që funksionojnë si të pavarura.

Një model për spin-out e sukseshme të universiteteve që bazohen në PI

Kërkuesit në Universitetin Warwick (Britani e Madhe) zhvilluan një teknikë për riciklimin e mbetjeve plastike, patentuan procesin dhe formuan një kompani spin-out.

Teknologjia Ricikluese sot ka zyrat e veta dhe një skuadër prej 10 punonjësish. Autoritetet lokale janë të interesuara në teknologjitë e kompanive spin-out: ato paguajnë për riciklimin e mbetjeve plastike momentalisht, por Teknologjia e Riciklimit u jep atyre mundësinë e krijimit të të ardhurave nga riciklimi. Profesor Jonathan Seville, inxhinieri kërkues i cili zhvilloi teknologjinë, vazhdon të jetë në bordin e kompanisë si këshilltar teknik.

Teknologjia e Riciklimit është vetëm një nga spin-outet të cilat kanë lindur në universitetet e Britanisë së Madhe çdo vit: në 2012/2013, shifra nga Këshilli Britanik për Financimin e Edukimit të Lartë (HEFCE) tregon se u themeluan 150 spin-out formale. Në të njëjtën kohë, pronësia intelektuale e zhvilluar në universitete solli 87 milion paund, dhe 955 patenta të grantuara.

Imprint

Publikuar nga

European Patent Academy European Patent Office Munich
Germany
© EPO 2015

Edituar nga

Peter Prowse

Dizajn

ANZINGER | WÜSCHNER | RASP
Munich

Foto

European Patent Office

Përkthyer nga:

AAG

Përkthim i edituar nga:

Drejtoria e Koordinimit, Promovimit të PI dhe Trajnimeve
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Printim

Gerber KG, Druck und Medien Munich

Botimet mund të shkarkohen pa pagesë nga faqja e internetit e EPO-s në adresën:

www.epo.org/teaching-kit.

“E Drejta e Autorit dhe Lirimi nga Përgjegjësia: Ky material është krijuar, përkthyer apo adaptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave **(DPPM)** me mbështetjen e Zyrës Europiane të Patentave **(EPO)**.

EPO nuk garanton që materiali nuk përmban gabime apo mungesa në të dhe zhvishet nga çdo përgjegjësi që lidhet me besueshmërinë e saj apo me pazotësinë e saj në përdorime dhe dëmtime të tjera të mundshme të kësaj natyre, humbje të informacionit, fitime apo të ardhura.

Versioni origjinal mund të jetë i disponueshëm në:

www.epo.org”

Infomacion Shtesë

Raport Vjetor 2014
www.epo.org/annual-report2014

Hyrje për patentat Europiane
www.epo.org/guide

Aplikimi online
www.epo.org/online-services

Vendimet e Bordit të Apelit
www.epo.org/appeals

Kërkimet për dokumentat e patentave
www.epo.org/searching

Akademia Europiane e Patentave
www.epo.org/academy

Çmimi i Shpikësit European
www.epo.org/european-inventor

Libri i mësimdhënies së PI
www.epo.org/teaching-kit

Publikime
www.epo.org/publications



www.epo.org
info@epo.org



**Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark",
Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë
Tel: +335(0)42236288,
Email: info@dppm.gov.al**